



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – PUNË”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“RINOVART-Qendër Rinore multifunkionale, rekreative, inovacion dhe art (Rikonstruksion)”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45210000-2** Punime ndërtimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**8 333 333** (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 7 500 000 (shtatë milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH**, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 833 333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, dhe Listën e Çmimeve (sipas zërave të preventivit) sipas Shtojcës 2;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

**3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;  
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **100%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim*
  - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
  - vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*
- b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
  - iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim*
  - vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e*

*pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”*

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 5** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që**



**prokurohet** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. **ii.** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që **prokurohet**. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkoni**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

**Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”** (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (si dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas nenit 55 pika 4/a të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

**Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës (pasi disponohet nga ana e tyre), por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë**

**informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.**

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
  - **Kategoria NP-1** (Punime gërmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NP-3** (Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada) – **Klasifikimi A**
  
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
  - **Kategoria NS-1** (Punime për prishjen e ndërtimeve) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-2** (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-4** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-12** (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) – **Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-14** (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.) – **Klasifikimi A**

\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licenca Profesionale.

2.3.3 **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- **ISO 14001** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **ISO 45001** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar të paktën nga njëri anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, licenca duhet të paraqitet nga operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet kjo licencë.*

- 2.3.5 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Pllaka grez**
- **Polisterol për veshje fasade**
- **Bojë hidromat/hidroplastike**

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave.
2. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.  
***Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
3. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 (*Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë*)/ ekuivalente dhe e vlefshme.

**Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;...”

***Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar***



*kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/a dhe 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. ”*

Në nenin 40 pika 6/ b dhe c të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me*

***karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.***

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-1 (Punime gjermimi në tokë)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punimet e sistemimit të jashtëm (Gjermim dheu me makineri..., mbushje..., etj); **kategorinë NP-3 (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)** e cila përfshin të gjitha zërat e punimeve në preventiv për punimet e rikonstruksionit të godinës civile, Qendrës Rinore Mat (Ish – shkolla fillore lagjia e Re, Burrel); **kategorinë NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)** në lidhje me zërat e punimeve të prishjes në preventiv (Prishje shtresash, prishje mur tulle, suvatimi... instalimeve elektrike/hidraulike etj., heqje dyer/ dritare... etj.); **kategorinë NS-2 (Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për instalimet hidrosanitare (Sistemi i furnizimit me ujë sanitar, rrjeti i shpërndarjes së ujit sanitar, furnizim – vendosja e pajisjeve hidraulike dhe sanitare..., shkarkimi i ujërave të zeza etj.); **kategorinë NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Punime betoni e hekuri, tarrace, muraturë, shtresash, suvatime, punime çatie, punime dyer/ dritare, punime për fasadën, bojatisje etj.); **kategorinë NS-12 (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (Punime dhe pajisje për mbrojtjen nga zjarri); **kategorinë NS-14 (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv për punime elektrike (Rrjeti elektrik dhe sistemit të kamerave, F.V. pajisje elektrike dhe sistemit të kamerave etj.), **si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.**
2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësisht:

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta;
  - ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit;
  - ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
3. Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, kanale*), prishje struktura dhe shtresa prej betoni, prishje (*mur tulle, shtresa etj.*), dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitetet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.
4. Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **20 (njëzet) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.7 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohej në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **15 (pësemëdhjetë) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Murator/ suvatues – jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Karpentier – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **2 (dy)** punonjës

- Hidroizolues – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Specialist duralumini – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Kopshtar – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Bojaxhi – jo më pak se **1 (një)** punonjës

\* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një)** inxhinier që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”**, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”* i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/çertifikata trajnimi.
- d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **2 (dy)** shoferë të mjeteve të rënda, dhe **1 (një)** manovratorë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë Individuale e Punës (të vlefshme),
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Çertifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP)

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*



## **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.**

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

**5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

**b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**

**c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;**

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **20 (njëzet) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, dhe natyrën e punimeve objekt kontrate, si dhe në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” është bërë një analizë bazuar tek faktorët si: zërat e punimeve dhe orët e punës, volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, dhe afatit të kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedurë prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.
2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit objekt prokurimi sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e prokurimit referuar zërave (natyrës) të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara**. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtröjmë:
  - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi rikonstruksioni të objektit, ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit të ndërtimit dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;
  - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Elektrik, pasi ky objekt përmban dhe kryerjen e punimeve të *instalimeve elektrike* ku është e nevojshme që këto punime të zbatohen me përgjegjshmëri dhe monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e inxhinierit të fushës;
  - Është kërkuar minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, pasi ky objekt krahas punimeve ndërtimore, përmban dhe kryerjen e punimeve të *instalimeve hidraulike dhe shkarkimeve të ujërave të zeza* ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur;

ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

3. Po ashtu, referuar natyrës, specifikës dhe volumit të punimeve që do të kryhen, për realizimin e tyre në përputhje me standartet teknike të zbatimit dhe brenda afatit të përcaktuar, njësia e prokurimit vlerëson të nevojshëm disponimin e **punonjësve të kualifikuar, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Murator/ Suvatues, Karpentier, Betonues, Elektriçist, Hidraulik, Hidroizolues, Specialist duralumini, Kopshtar, Bojaxhi**, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/ certifikatat e kualifikimit për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
4. Në lidhje me kërkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) inxhinieri që përmbush kriteret për të qenë përgjegjës në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi **nevojitet për përshtatjen e kantierit sipas fazave të punimeve, mbajtjen e kantierit në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve** kërkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”.
5. Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt me anë të një deklaratë, i cili të jetë i përfshirë në liçensimin e shoqërisë, dhe duhet të ndjekë punimet që do të kryen në objektin e kontratës.
6. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për disponimin në stafin e tyre, e të paktën **2 (dy)** shoferë të mjeteve të rënda, dhe **1 (një)** manovratorë, të cilët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim transportimin e materialeve dhe inerteve si dhe gërmimeve për kryerjen e punimeve objekt kontrate, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve shoferë dhe manovratorë, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen përfshirë dhe transportin e materialeve dhe inerteve, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

**Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

### 2.3.9 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes</b>	<b>Sasia</b>
<b>1.</b>	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>2.</b>	Kamion vetëshkarkues me vinç dhe kapacitet mbajtës deri 5 ton	<i>jo më pak se 2 copë</i>
<b>3.</b>	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>4.</b>	Minifadromë	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>5.</b>	Fadromë me goma	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>6.</b>	Betoniere Kantieri	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>7.</b>	Vibrator Betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>8.</b>	Skeleri	<i>jo më pak se 100 m<sup>2</sup></i>
<b>9.</b>	Armatura betoni	<i>jo më pak se 100 m<sup>2</sup></i>
<b>10.</b>	Depozitë uji ( <i>jo më pak se 1000 litra</i> )	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>11.</b>	Gjenerator	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>12.</b>	Karrocë dore	<i>jo më pak se 3 copë</i>

- b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 15 copë*
  - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 2 copë*
  - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 1 copë*
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
- **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruara me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/d** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...** d) **mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**”



Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, ku vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkuara me anë të cilave do të kryhen punimet e ndërtimit dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e këtyre punimeve objekt kontrate. **Njësia vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë prokurim.** Gjithashtu, me qëllim përmbushjen e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier*”, njësia e prokurimit vendosi të kërkojë që operatorët ekonomik pjesëmarrës **duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.** Njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin operatorët ekonomik pjesëmarrës me qëllim vërtetimin e disponimit të tyre, dhe dokumentacionin tekniko-ligjor për automjetet të cilat duhet të regjistrohen në regjistrat publik për qarkullimin e tyre.

### 2.3.10 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

#### **Argumentimi:**

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;**”

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej **4 (katër) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

#### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.1419, datë 08.04.2024** “Kërkesë për objektin: “RINOVART-Qendër Rinore multifunksiionale, rekreative, inovacion dhe art (Rikonstruksion)” dërguar nga Drejtoria e Shërbimeve/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar *Projekt – Preventivat, Relacionet, Raportet, Grafikun e punimeve dhe Specifikimet Teknike* përkatëse për punimet objekt prokurimi të kryera nga një shoqëri e licënsuar në projektim, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik<sup>1</sup>” (i ndryshuar), dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 22.07.2024, ora 11.00, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)** .

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

### **NJËSIA E PROKURIMIT**